



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 452/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, përkitazi me ankesën e subjekti politik Fryma e Re (FER) paraqitur kundër Mirsad Fazliu dhe Ruzhdi Thaqi anëtarë i këshillit dhe kryesues i vendvotimit 1919E në Prishtinë, në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 13.12.2010, mori:

### VENDIM

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER)

### ARSYETIMI

Më datë 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik FER, e cila thekson se me datë 12.12.2010 në orën 12:30, Valdete Daku në rolin e vëzhgueses ka vërejtur se detektorët nuk punojnë dhe janë duke u përdorur vetëm formalisht. Po ashtu sipas parashtruesit të ankesës theksohet se Valdete Daku ka dëgjuar Mirsad Fazliun anëtarë të këshillit të vendvotimit (VV) në qendrën 1919E, VV nr. 07 në Prishtinë, të ketë thënë “se është e vërtetë që detektorët nuk punojnë sepse ai ka parë të njëjtin person të ketë votuar 2 deri 3 herë”. Parashtruesi i ankesës pretendon se Mirsad Fazliu nuk e ka raportuar këtë rast tek kryesuesi i VV-se Ruzhdi Thaqi. Përmes kësaj ankesë parashtruesi pretendon se është bërë shkelje e nenit 89 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme (LPZ).

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale, përveç se ka siguruar një numër telefoni i cili i perket Valdete Dakes vëzhguese dhe dëshmitare në vendngjarje.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si më poshtë:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizo shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

PZAP-i vlerëson se ankesa e FER-it paraqitur kundër kryesuesit dhe anëtarit të këshillit të vendotimitit është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe rregullimin e detektorëve fakt ky qe konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura me lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 452/2010 më datën 13.12.2010.

